



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 10 Shkurt 2022

Nr: 16

V E N D I M

P Ë R

**PROCEDURËN E HEDHJES SË SHORTIT PËR PËRCAKTIMIN E RENDITJES SË
SUBJEKTEVE ZGJEDHORE NË FLETËN E VOTIMIT, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME
PËR KRYETAR BASHKIE, TË DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit nr. 13 438, datë 20.01.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, të neneve 20, pika 1, shkronja “a”, dhe 98, pika 5, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

Neni 1

Objekti

Ky vendim përcakton rregullat për hedhjen e shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit, duke u bazuar në parimin e objektivitetit, transparencës dhe barazisë.

Neni 2

Renditja e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie

1. Renditja e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, bëhet me short.
2. Në rast se në përfundim të hedhjes së shortit renditen njëri pas tjetrit subjekte zgjedhore të cilat kanë emrin zyrtar, emblemën (siglën) apo shkronjat nistore të përafërta dhe që mund të shkaktojnë konfuzion apo lajthitje te votuesit, me kërkesë të subjekteve, shorti mund të përsëritet jo më shumë se dy herë të tjera, deri në renditjen që nuk shkakton konfuzion te votuesit.

Neni 3

Veprimet paraprake



1. Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ-së), njofton përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore për datën, vendin dhe orën e caktuar për organizimin e shortit.
2. Data, vendi dhe ora e zhvillimit të shortit publikohen në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së dhe shpallet në hyrjen e saj në këndin e njoftimeve.
3. Mosparaqitja e ndonjë prej përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore nuk pezullon procedurat e shortit. Në këtë rast, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve cakton një nëpunës të administratës së KQZ-së të realizojë procedurën e parashikuar në këtë vendim për subjektin zgjedhor, përfaqësuesi i të cilit nuk është i pranishëm.

Neni 4

Procedura e shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore

1. Në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie organizohet shorti për renditjen në fletën e votimit të subjekteve zgjedhore, për çdo zonë zgjedhore (bashki).
2. Renditja e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit përcaktohet nëpërmjet dy proceseve, parashortit dhe shortit. Në parashort përcaktohet radha ndërmjet subjekteve zgjedhore për të tërhequr numrin që do të ketë subjekti në fletën e votimit. Shorti përcakton numrin që do të mbajë subjekti zgjedhor në fletën e votimit. Parashorti dhe shorti zhvillohen sipas procedurës së mëposhtme:
 - a) Parashorti zhvillohet për çdo zonë zgjedhore (bashki), sipas kësaj procedure:
 - i) KQZ-ja cakton një person nga administrata për procesin e parashortit.
 - ii) Përgatiten në shirita letre emrat e subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në short dhe sigurohen numër goglash i barabartë me numrin e shiritave. Shiritat e letrës janë të barabartë dhe verifikohen për saktësi nëpërmjet ekspozimit nga Sekretari i Përgjithshëm/ personi i autorizuar nga të gjithë të pranishmit. Goglat duhet të jenë të së njëjtës ngjyrë, pa shenja apo shënime dhe të së njëjtës peshë e madhësi.
 - iii) Në tryezën ku hidhet shorti vendosen shiritat me numrat rendorë dhe goglat. Në secilën prej goglave futet nga një shirit letre e më pas, goglat futen në një enë transparente. Goglat përzihen me qëllim sigurimin e barazisë në përzgjedhje.
 - iv) Personi i caktuar nga administrata e KQZ-së, pasi i përzien goglat, tërheq një prej tyre, e hap, lexon emrin e subjektit zgjedhor që është shënuar në shiritin brenda saj dhe ia dorëzon Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së.
 - v) Subjekti zgjedhor që është shënuar në shiritin e letrës brenda goglës së parë, do të jetë i pari që do të tërheqë në shortin që do të zhvillohet sipas procedurës së përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 2, të këtij neni, e kështu do të vazhdohet deri në tërheqjen e të gjitha goglave brenda në enë.
 - b) Shorti zhvillohet për çdo zonë zgjedhore (bashki), sipas kësaj procedure:

- i) Përgatiten shirita letre ku në secilin prej tyre shënohet një numër duke filluar nga numri 1 (një) deri tek numri i barabartë me numrin e subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në short dhe sigurohen numër goglash i barabartë me numrin e shiritave. Shiritat e letrës dhe goglat plotësojnë kriteret e nënndarjes “ii”, të shkronjës “a”, të pikës 2, këtij neni. Shiritat verifikohen për saktësi nëpërmjet ekspozimit nga Sekretari i Përgjithshëm/ personi i autorizuar nga të gjithë të pranishmit.
 - ii) Në tryezën ku hidhet shorti vendosen shiritat me numrat rendorë dhe goglat. Në secilën prej goglave futet nga një shirit letre e më pas, goglat futen në një enë transparente. Goglat përzihen me qëllim sigurimin e barazisë në përzgjedhje.
 - iii) Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore tërheqin nga ena një gogël sipas radhës së përcaktuar në parashort. Përfaqësuesi i subjektit zgjedhor hap goglën dhe lexon numrin që është shënuar në të. Ky numër do të jetë numri rendor që subjekti zgjedhor do të ketë në fletën e votimit.
3. Procedura e zhvilluar sipas pikës 2 të këtij neni, përsëritet për secilën zonë zgjedhore (bashki) sipas renditjes në dekretin nr. 13 438, datë 20.01.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”.
 4. Administrata e KQZ-së mban procesverbalin e rezultatit të shortit.

Neni 5

Rezultati i shortit

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton me vendim rezultatin e shortit për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për çdo zonë zgjedhore (bashki).

Neni 6

Hyrja në fuqi

1. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Ilirjana NANO **Kryetar**

Arens ÇELA **Anëtar**

Dritan ÇAKA **Anëtar**

Helga VUKAJ **Anëtar**

Muharrem ÇAKAJ **Anëtar**

